VENDIM
Nr.169, datë 17.3.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE TË ISH-REPARTIT "RENEA", DREJTORIA E FORCËS SË POSAÇME OPERACIONALE, LINZË, BASHKIA TIRANË, DHE CAKTIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT SI NJËSI ZBATUESE

(Ndryshuar me VKM nr. 685, datë 6.12.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objekteve të ish-repartit "Renea", Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Linzë, Bashkia Tiranë, në masën 263 752 795 (dyqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

2. Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i shtohet fondi në masën 131 876 397 (njëqind e tridhjetë e një milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të objekteve, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

2/1. Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i shtohet fondi në masën 131 876 398 (njëqind e tridhjetë e një milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të objekteve të ish-repartit "RENEA", Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Linzë, Bashkia Tiranë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.

3. Caktimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si njësi zbatuese për rikonstruksionin e objekteve të ish-repartit "Renea", Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Linzë, Bashkia Tiranë.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe